

AKT THEMELIMI DHE STATUT

I SHOQËRISË

TESORO-AL SHPK

KAPITULLI I

KRIJIMI, FORMA, QELLIMI, OBJEKTI, KOHËZGJATJA, EMËRTIMI, SELIA

NENI 1

KRIJIMI I SHOQËRISË

1. Sot ne date 04/03/2021 themelohet shoqeria me pergjegjesi te kufizuar me emertimin **“TESORO-AL” shpk**, (Me poshte referuar si **“Shoqeria”**).
2. Shoqeria eshte person juridik shqiptar dhe funksion ne perputhje me kerkesat e ligjit nr.9901 date 14.04.2008 **“ Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare “** te ndryshuar.
3. Shoqeria gezon te drejta si person juridik shqiptar qe prej dates, ne te cilen organet kompetente kane dhene aprovimin per themelimin e saj.
4. Shoqëria e ushtron aktivitetin e saj në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe me dispozitat e parashikuara në dokumentat themeluese.

NENI 2

FORMA E SHOQËRISË

1. Shoqëria do të ketë formën e shoqërisë me pergjegjesi te kufizuar, për sa kohë që Ortaket e kesaj shoqerie nuk do të marrin një vendim për shndërrimin e saj.
2. Veprimtaria e shoqërisë do të rregullohet sipas radhes nga dispozitat e ketij statuti dhe dispozitat përkatëse të ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008 **“Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare”**, te ndryshuar, per aq kohe sa dispozitat e ketij statuti nuk vijne ne kundershtrim me ligjin e mesiperm.

NENI 3

EMËRTIMI

Emërtimi i shoqërisë është **“TESORO-AL” sh.p.k** . Në të gjitha aktet dhe dokumentet e nxjerra nga shoqëria, emërtimi i shoqërisë do të ndiqet nga fjalët **“Shoqëri me Pergjegjesi te Kufizuar”** ose inicialet sh.p.k .

NENI 4

SELIA E SHOQERISE

1. Shoqëria e ka selinë ne qytetin e Tiranës, ne adresen: Rr. Dervish Hima, Kulla 1, shkalla 1, kati i I-re, Tirane.



2. Përveç veprimtarisë në nivel lokal, shoqëria ka të drejtën e krijimit dhe mbylljes së filialeve, agjencive dhe zyrave të përfaqësimit brenda apo jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.
3. Selia mund të transferohet në çdo vend tjetër brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, me një vendim të Asamblese se Ortakeve te kesaj shoqerie.

NENI 5 **KOHËZGJATJA**

1. Kohëzgjatja e shoqërisë është pa afat.
2. Në përputhje me këtë statut, shoqëria mund të mbyllë veprimtarinë e saj ne cdo kohe e kur e sheh të arsyeshme, apo në rastet e parashikuara nga ligji.

NENI 6 **QELLIMI DHE OBJEKTI**

1. Objekti i veprimtarisë së shoqërisë është :
 - Pajisje dhe shërbime hotelerie.
 - Shitje dhe montim te kasafortave te sigurise.
 - Shërbime konsulence ne fushen e hoteleri-turizmit.
2. Shoqëria mund te ndryshoje dhe te shtoje ne cdo kohe objektin e veprimtarise se saj sipas rregullave te parashikuara ne statutin e saj dhe ne legjislacionin tregtar.

KAPITULLI II

KAPITALI THEMELTAR, KUOTAT DHE KALIMI I KUOTAVE

NENI 7 **KAPITALI THEMELTAR**

1. Kapitali themeltar i shoqerise eshte ne vleren 500.000 (pesenjeqind mije) Leke. Ai mund te rritet ose te zvoglohet me vendim te asamblese sipas normave te fushes ne fuqi.

NENI 8 **ORTAKET DHE KUOTAT**

Shoqëria perbehet nga ortakut i vetem i saj :

Altin Lamaj shtetas shqiptar, madhor me zotesi juridike per te vepruar, i biri Zhezairit, lindur ne date 01.12.1976 ne Tirane, banues ne Rr. Dervish Hima, Kulla 1, shkalla 1, kati i I-re, Tirane, qe zoteron 1 kuote ne vlere prej 500.000 leke.

NENI 9 **MENYRA E FITIMIT DHE KALIMIT TE KUOTAVE**



1. Kuotat e kapitalit shoqerise e te drejttat dhe detyrimet qe rrjedhin prej tyre mund te fitohen apo kalohen nepermjet:
 - a. Kontributit te ortakeve ne kapitalin e shoqerise;
 - b. Shitblerjes;
 - c. Trashegimise;
 - d. Dhurimit;
 - e. Çdo menyre tjeter parashikuar ne ligj.
2. Ne rastet e kalimit te kuotave me kontrate, kushtet dhe momenti i kalimit te titullit te pronesise mbi kuoten, si dhe kushtet e tjera te kalimit, perfshire momentin e pageses se cmimit, rregullohen nga kontrata.
3. Kontrata per kalimin e kuotes hartohet ne forme shkresore dhe noterizimi nuk perben kusht per vlefshmerine apo regjistrimin e kontrates.
4. Me perjashtim te rasteve kur parashikohet shprehimisht ndryshe nga ligji apo kur palet bien dakord ne kontrate, vlefshmeria e kalimit te titullit te pronesise mbi kuotat nuk do te kushtezohet nga kryerja e formaliteteve te ndryshme me efekt deklarativ, perfshi ketu formalitetet e regjistrimit ose te publikimit te kontrates apo te kalimit te titullit.
5. Me perjashtim te kalimit te kuotave nepermjet trashegimise, ne rastet e tjera ortaket duhet te miratojne me vendim te asamblese, transferimin e kuotave jashte shoqerise. Pas momentit te kalimit te kuotave me ane te trashegimise, per trashegimtarete zbatohen dispozitat e parashikuara ne piken 3-10 te ketij neni.
6. Ortaket ne rastin kur mendojne qe te transferojne pjeserisht apo teresisht kuotat e tyre nepermjet shitblerjes duhet te kryejne proceduren e parablerjes se kuotave ndaj te ortakeve te tjere. Afati qe secili nga ortaket duhet te vleresoje oferten eshte 90 (nentedhete) dite kalendarike nga data e marrjes se ofertes.
7. Oferta duhet te dergohet ne forme te shkruar (poste rekomande) dhe ne forme elektronike (email), ne adresen e secilit ortak te regjistruar prane shoqerise. Ortaku detyrohet te depozitoje ndryshimet e adreses se banimit prane shoqerise. Ne rastin qe ortaken nuk e kane depozituar ndryshimin prane shoqerise, ortaku qe kerkon te shese ose transferoje mund te njoftoje direkt ne adresen e shoqerise, ndaj prezumohet qe ortaket e tjere, kane marre dijeni brenda 7 diteve nga dita e mbritjes se njoftimit ne adresen zyrtare te shoqerise.
8. Oferta duhet te permbaje daten, adresen e sakte te ortakut qe i drejtohet, numrin e kuotave qe kerkon te disponoje, cmimin e ofruar per kuote dhe/ose ne total, formen e monedhes (nese eshte ndryshe nga ajo e kapitalit te regjistruar te shoqerise) dhe kursin e kembimit, kushtet e shitjes, afatin e kthimit te pergjigjes, adresen e sakte (vendin ku ortaku/et do qe te vijne pergjigjet e ofertave dhe emailin) te ortakut qe kerkon te shese kuotat. Mosrespektimi i ketyre elementeve e ben oferten te pavlefshme. Nese ortaku nuk vendos adrese ne oferte, atehere adresa eshte vendbanimi i tij zyrtar i regjistruar ne gjendjen civile, te percaktuar ne kete staut. Nese njoftimi i eshte derguar ne kete adrese, konsiderohet qe ai eshte njoftuar.
9. Nese ortaku apo ortaket e shoqerise e pranojne oferten ne kushtet e parablerjes, ata duhet te shprehen qarte dhe hapur per vullnetin e tyre te lire dhe te pakushtezuar ne pranimin e ofertes.
10. Ne rast se ortaku brenda 60 diteve kalendarike refuzon oferten ose nuk shprehet fare ne lidhje me te, atehere procedura e parablerjes konsiderohet e kryer dhe ortaku eshte i lire qe te shese kuotat e tij jashte shoqerise me nje vlere te barabarte ose me te madhe se ajo e paraqitur ne oferte.
11. Ne cdo rast, asambleja duhet te miratoje shitjen e kuotave jashte shoqerise me shumice te cilesuar me anetaret qe jane prezente ne mbledhje, ne kete rast, vota e ortakut qe kerkon te shese kuotat, perjashtohet nga votimi.
12. Ndalohet shitja dhe/ose dhurimi i kuotave ndaj personave fizike apo juridike, veprimtaria e te cileve eshte ne konkurrence me shoqerine dhe duket hapur qe dhurimi apo shitja e tyre demton veprimtarine e shoqerise. Perjashtohet rasti, kur ortaket e shoqerise, edhe pse sa me siper duket



- hapur, ata jane shprehur me vendim qe jane dakort me shitjen apo dhurimin e kuotave. Ne kete vendim, nuk perfshihet ortaku qe kerkon te shese apo dhuroje kuotat e tij.
13. Nese ortaket e tjere nuk ushtrojne te drejten e parablerjes, vec e vec dhe/ose sebashku, sipas afateve te percaktuara me lart, ortaku shites eshte i lire qe kuotat e ofruara t'ia shese te treteve, brenda 30 (tridhjete) diteve kalendarike, nga mbarimi i afatit prej 60 ditesh kalendarike ose nga dita e kthimit te pergjigjes negative nga ortaket e tjere.
 14. Ne rast se te gjitha ortaket pranojne oferten e ortakut, atehere vlera e kuotave qe jane nxjerre ne shitje, ndahet ne perpjestim te drejte, me perqindjen e ortakeve te tjere ose te barabarte nese kuotat jane te shperndara ne menyre te barabarte.
 15. Ne rast se ortaku qe kerkon te shese kuotat e tij pjeserisht apo plotesisht deshton ne shitjen e tyre dy here radhazi, keto kuota mund te anulohen ose te likujdohen, me miratimin e ortakut, sipas nenit 80 te Ligjit nr.9901, date. 14.04.2008, "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare". Ne cdo rast, anullimi dhe likudimi i kuotave ne fjale shoqerohet me vendim te Asamblese se Pergjithshme, vendimi per anulimin ose likujdimin duhet te merret me shumice te cilesuar te anetareve prezente ne mbledhjen e asamblese.

NENI 10

PASOJAT E KALIMIT TE KUOTAVE, PJESTIMI DHE TRANSFERIMI I TYRE

1. Personi qe kalon kuoten dhe ai qe e perfiton ate, pergjigjen ne menyre solidare ndaj shoqerise per detyrimet qe rrjedhin nga zoterimi i kuotes , nga çasti i kalimit te kuotave, deri ne çastin e regjistrimit te kalimit, sipas pikes 2 te nenit 74 te Ligjit Per shoqerite tregtare.
2. Shoqeria realizon kalimin e kuotes, sipas nenit 43 te ligjit nr.9723, date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit".
3. Kuotat jane lirisht te transferueshme midis ortakeve te shoqerise. Rregulli i kushtezimit te transferimit nuk zbatohet ne rast te transferimit per shkak trashegimie ose transferimit tek pjesetaret e familjes.

KAPITULLI III

MARREDHENIET NDERMJET SHOQERISE DHE ORTAKEVE

NENI 11

SHPERNDARJA E FITIMEVE

1. Ortaket kane te drejte te ndajne sipas perqindjes se pjesemarrjes ne shoqeri, pjesen e fitimit te deklaruar ne pasqyrat financiare te shoqerise dhe te miratuara nga nje ekspert kontabel i miratuar dhe prej asamblese se ortakeve me vendim. Shoqeria mund te mos ndaje fitim edhe kur realizon fitim, nese mbledhja e asamblese ka vendosur per kete qellim.
2. Administratori i shoqerise ne rastin e shperndarjes se fitimit duhet qe dokumentin perkeates qe autorizon strukturen perkatese per kalimin e fitimeve ndaj ortakeve te shoqerise, ta shoqeroje me vendimin perkates te asamblese, i cili miraton ne parim shperndarjen e vendimeve.

NENI 12

KUFIZIMET E SHPERNDARJES, ÇERTIFIKATA E AFTESISE PAGUESE, PERGJEGJESITE



1. Shoqeria mund t'u shperndaje fitim ortakeve, vetem nese pas pagimit te dividendit:
 - a. Aktivet e shoqerise mbulojne teresisht detyrimet e saj;
 - b. Shoqeria ka aktive likuide te mjaftueshme per te shlyer detyrimet qe behen te kerkueshme brenda 12-muajve ne vazhdim.
2. Administratori leshon nje certifikate te aftesise paguese, e cila konfirmon shprehimisht se shperndarja e propozuar e dividendeve permbush kerkesat e paragrafit te pare te ketij neni, ndersa kur gjendja e shoqerise tregon se shperndarja e propozuar e dividendeve nuk i permbush keto kritere, administratori nuk mund te leshoje kete certifikate .
3. Administratori pergjigjet ndaj shoqerise per vertetesine e certifikates se aftesise paguese.
4. Administratori, i cili nga pakujdesia leshon nje certifikate te pasakte te aftesise paguese, pergjigjet personalisht perpara shoqerise per kthimin e dividendeve te shperndare.
5. Ortaket, qe kane mare nga shoqeria dividend, pergjigjen personalisht ndaj shoqerise per kthimin e dividendeve, pavaresisht leshimit te certifikates, nese keta ortake kane pasur dijeni per gjendjen e paaftesise paguese te shoqerise sipas paragrafit te pare te ketij neni.

KAPITULLI IV

ORGANET DREJTUESE TË SHOQËRISË

Organet drejtuese të shoqërisë janë:

1. Asambleja e Pergjithshme

2. Administratori

ASAMBLEJA E PERGJITHSHME

NENI 13

TE DREJTAT DHE DETYRAT

1. Asambleja e Pergjithshme eshte pergjegjese per marrjen e vendimeve per shoqerine per ceshtjet e meposhteme :
 - a) Percaktimin e politikave tregtare te Shoqerise;
 - b) Ndryshimet e statutit;
 - c) Emerimin dhe shkarkimin e Administratorit ;
 - d) Emerimin dhe shkarkimin e likujdvesve dhe eksperteve kontabel te autorizuar;
 - e) Percaktimin e shperblimeve per personat e permendur ne shkronjat c dhe d, te kesaj pike ;
 - f) Mbikqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratori, perfshire pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise ;
 - g) Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise ;
 - h) Zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit;
 - i) Pjestimin e kuotave dhe anulimin e tyre ;
 - j) Perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratorit ;
 - k) Riorganizimin dhe prishjen e shoqerise ;
 - l) Për miratimin e marrjes së audituesve te jashtem, në rastet e hetimeve te posacme;
 - m) Miratimin e struktures se shoqerise dhe nivelet e pagave per vend pune;
 - n) Shperndarjen e fitimeve per ortaket;
 - o) Investime afatshkurtra dhe afatgjata;
 - p) Miratimin e marrjes se kredive bankare;



- q) Krijimin dhe perdorimin e fondit rezerve te shoqerise;
 - r) Shnderrimin e formes se shoqerise dhe/ose bashkimin me shoqeri te tjera, apo pjesemarrjen ne shoqeri apo grupe shoqerish;
 - s) Miratimin e formes, permbajtjes dhe perdorimit se rregjistrimit te shoqerise per rregjistrimin e vendimeve te shoqerise, dhe strukturen pergjegjese per administrimin e tij;
 - t) Miratimin e rregulloreve te ndryshme te punes si dhe rregulloreve te tjera qe ne thelb kane te bejne me procese te rendesishme te veprimtarise se shoqerise ;
 - u) Miratimin ne rastin e shitblerjes se koutave te ortakeve ose formave te tjera te transferimit te tyre, sipas parashikimeve te ketij statuti.
 - v) Miratimin ne rastet e dhenies apo marrjes me qira te sendeve prodhuese te luajtshme.
2. Duhet regjistruar ne veçanti ne Qendren Kombetare te Biznesit, por pa u kufizuar ne to, vendimet e asamblese per :
- a) Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
 - b) Shperndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve ;
 - c) Investime;
 - d) Vendimet per riorganizimin dhe prishjen e shoqerise.
 - e) Vendime te tjera qe asambleja e pergjithshme vlereson se duhen regjistruar.
3. Vendimet e paregjistruara ne regjistrin e vendimeve jane absolutisht te pavlefshme. Shoqeria nuk mund t'i kundrejtoje pavlefshmerine te tretit, qe ka fituar te drejta ne mirebesim, pervec rastit kur shoqeria provon se i treti ka pasur dijeni per pavlefshmerine, apo ne baze te rrethanave te qarta nuk mund te kishte pasur dijeni per te .

NENI 14

MBLEDHJA E ASAMBLESE SE PERGJITHSHME

1. Asambleja e Përgjithshme mbledhet në rastet e përcaktuara nga ligji Per shoqerite tregtare, nga ligje të tjera ose nga dispozitat e statutit dhe sa herë që mbledhja është e nevojshme për të mbrojtur interesat e shoqërisë. Mbledhja e zakonshme e asamblesë së përgjithshme thirret të paktën 1 herë në vit.
2. Asambleja e përgjithshme thirret nga administratori dhe/apo ortakët e përcaktuar sipas nenit 84 të ligjit “Per tregtaret dhe shoqerite tregtare”, Nr. 9901, dt. 14.04.2008 te ndryshuar.
3. Asambleja e përgjithshme duhet te thirret nëse, sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.
4. Asambleja e përgjithshme duhet thirret kur shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
5. Asambleja e përgjithshme duhet te thirret kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak, pasuri që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
6. Në rastet e parashikuara në pikat 3 e 5 të këtij neni, asamblesë së përgjithshme i paraqitet një raport nga një ekspert kontabël i autorizuar, i pavarur.
7. Dispozitat e pikës 6 të këtij neni nuk zbatohen nëse blerjet sipas pikave 4 e 5 të këtij neni, kryhen në bursë ose janë pjesë e veprimeve të përditshme të shoqërisë dhe bëhen në kushte normale tregu.



8. Në rastet e parashikuara në pikat 3 deri në 5 të këtij neni, asambleja e përgjithshme mund të miratojë një rezolutë këshilluese, duke miratuar apo bërë vërejtje për veprimtarinë e administratorit.

NENI 15 **MENYRA E THIRRJES**

1. Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë poste rekomande dhe me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 (shtate) ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.
2. Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

NENI 16 **KERKESAT NGA ORTAKET E PAKICES**

1. Ortakët, të cilët përfaqësojnë të paktën 5 për qind të totalit të votave në asamblenë e përgjithshme të shoqërisë, apo një pjesë më të vogël të parashikuar në statut, mund t'i drejtojnë administratorit një kërkesë me shkrim, përfshirë postën elektronike, për të thirrur asamblenë e përgjithshme dhe/ose përfshirjen e çështjeve të posaçme në rendin e ditës. Kërkesa duhet të përmbajë arsyet, objektivat dhe çështjet, për të cilat asambleja duhet të marrë një vendim. Nëse kërkesa refuzohet, këta ortakë kanë të drejtë ta thërrasin asamblenë dhe të caktojnë çështjet e rendit të ditës, në përputhje me pikën 1 të nenit 83 të ligjit Nr. 9901, dt. 14.04.2008 "Per tregtare dhe shoqërite tregtare".
2. Nëse, në kundërshtim me pikën 1 të këtij neni, asambleja e përgjithshme nuk thirret, ose çështja e kërkuar prej këtyre nuk futet në rendin e ditës, secili prej ortakëve, që kanë bërë kërkesën, ka të drejtë:
 - a) të ngrejë padi në gjykatë, për të deklaruar shkeljen e detyrimit të besnikërisë, nëse administratori nuk përmbush kërkesat e ortakëve brenda 15 ditëve;
 - b) t'i kërkojë shoqërisë blerjen e kuotave, të zotëruara prej tyre.
2. Në rastet kur rendi i ditës ndryshohet, sipas parashikimeve të pikave 1 e 2 të këtij neni thirrja i është njoftuar ortakëve, administratori njofton përsëri rendin e ditës, të ndryshuar, në përputhje me parashikimet ligjore dhe statutore.
3. Ndryshimet në rendin e ditës si rregull lejohen të bëhen jo më vonë se 3 (tre) ditë nga data e marrjes së njoftimit të zhvillimit të mbledhjes. Në cdo rast, para fillimit të mbledhjes lejohet që ortakët e pranishëm, ne unanimitet mund të bëjnë ndryshime në rendin e ditës.
4. Përfaqësuesi i autorizuar është i detyruar të deklarojë çdo fakt apo rrethanë, të tillë që, sipas gjykimit të ortakut të përfaqësuar, rrezikon të ndikojë në vendimmarrjen e përfaqësuesit për interesa të tjerë të ndryshëm nga ata të ortakut të përfaqësuar.

NENI 17 **PERFAQESIMI NE ASAMBLE**

1. Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi (ne rastet kur ortakut është person juridik) ose prokure të posaçme (ne rastet kur ortakut është person fizik) nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë. Në cdo rast përfaqësimi të një apo disa ortakëve, drejtuesi i mbledhjes së asamblesë duhet të verifikojë ligjshmërinë e autorizimit të përfaqësimit. Përfaqësuesit e autorizuar do të pranohen në mbledhje veten nëse autorizimi i tyre plotëson kushtet e parashikuara nga legjislacioni shqiptar mbi përfaqësimin.



2. Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.
3. Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

NENI 18

KUORUMI

PER VENDIMET ME SHUMICE TE THJESHTE

1. Në rastin e marrjes së vendimeve që kërkojnë shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme, vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zoterojnë më shumë se 50% (pesëdhjetë) të kuotave.
2. Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje që kërkojnë shumicë të cilësuar, që parashikohen në nenin 87 të ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe Shoqëritë tregtare", kuorumi i nevojshëm është ai i përcaktuar në nenin 19 të këtij statuti.
3. Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet, për shkak të mungesës së kuorumit në pikën 1 të këtij neni, asambleja mbledhet perseri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

NENI 19

KUORUMI

PER VENDIMET ME SHUMICË TË CILËSUAR

1. Asambleja merr vendim me $\frac{3}{4}$ (tre të katërtat) kur marrin pjesë në mbledhje ortakët me të drejtë vote që zoterojnë më shumë se 75% (shtatëdhjetë e pesë) të kuotave të shoqërisë, në rastet e mëposhtme:
 - a) për ndryshimin e statutit,
 - b) zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar,
 - c) shpërndarjen e fitimeve,
 - d) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë,

NENI 20

MARRJA E VENDIMEVE NDAJ ORTAKEVE

Vlefshmëria e vendimeve, që përcaktojnë detyrime shtesë mbi ortakët, apo vendimet që kufizojnë të drejtat e tyre, të parashikuara në ligj ose në statut, nuk kushtëzohet nga miratimi i ortakut përkatës.

NENI 21

E DREJTA E VOTES

1. Çdo ortak ka të drejtë vote në proporcion me vlerën nominale të kuotes së tij. Bashkëzotuesit e një kuote ushtrojnë të drejtat e votes bashkërisht, sipas nenit 72 të ligjit.
2. Ortakët, që nuk mund të jenë të pranishëm fizikisht në vendin ku zhvillohet mbledhja e asamblesë së përgjithshme kanë të drejtë që të përfaqësohen, ose të marrin pjesë nëpërmjet mjeteve të ndryshme komunikimi, përfshirë mjetet elektronike, me kusht që të garantohet plotësisht identifikimi i ortakëve.
3. Mjetet elektronike përfshijnë, por pa u kufizuar në to:
 - a) transmetimin e mbledhjes së asamblesë së përgjithshme në kohë reale;
 - b) komunikimin e ndërsjellë në kohë reale, i cili u mundëson ortakëve të shprehin për mbledhjen e asamblesë së përgjithshme nga një vendndodhje tjetër;



- c) mekanizma, që mundësojnë procesin e votimit, përpara apo gjatë mbajtjes së mbledhjes së asamblesë së përgjithshme, pa qenë nevoja të caktohet një përfaqësues i autorizuar, për të marrë pjesë fizikisht në mbledhje.
4. Përdorimi i mjeteve elektronike, për t'u mundësuar ortakëve të marrin pjesë në mbledhjen e asamblesë së përgjithshme, bëhet me kushtin që të merren masat teknike të nevojshme për të garantuar identifikimin e ortakëve dhe sigurinë e komunikimeve elektronike, deri në atë masë që ky përdorim të jetë proporcional me arritjen e këtyre qëllimeve. Nëse gjatë zhvillimit të mbledhjes ndodh që të ndërpritet komunikimi mes ortakut/ve me mbledhjen për arsye teknike apo të forcave madhore, dhe ortaku apo ortakët nuk kanë përfaqësuesit e tyre fizikisht në vendin ku zhvillohet mbledhja, atëherë vendimarrja do të konsiderohet e rregullt për aq kohë sa ishte vendosur lidhja e drejtpërdrejtë me mbledhjen me ortakun dhe/ose ortakët, gjë e cila duhet shënuar në procesverbalin e mbledhjes. Asambleja me një shumicë mbi 50 % të kuotave mund të vendosë përpara zhvillimit të mbledhjes, që në mbledhje të caktuara të asamblese të jete prezent dhe një noter publik.
5. Ortakët kanë të drejtën, që u njihet nga ligji apo ky statut, për të marrë unanimisht çdo vendim, me kusht që kjo marrëveshje të bëhet me shkrim.

NENI 22 **PERJASHTIMI NGA E DREJTA E VOTES**

1. Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:
 - a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
 - b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
 - c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
 - d) dhënien ose jo të përfitimeve të reja.
2. Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

NENI 23 **PROCESVERBALET E MBLEDHJES SE ASAMBLESE**

1. Të gjitha vendimet e asamblesë së përgjithshme duhet të regjistrohen në procesverbal. Administratori përgjigjet për ruajtjen e kopjeve të procesverbaleve të mbledhjeve të asamblesë së përgjithshme.
2. Procesverbali duhet të përmbajë datën e vendin e mbledhjes, rendin e ditës, emrin e kryetarit e të mbajtësit të procesverbalit, rezultatet e votimit.
3. Procesverbalit i bashkëlidhet lista e pjesëmarrësve dhe njoftimi i thirrjes së asamblesë së përgjithshme.
4. Procesverbali i mbledhjes nënshkruhet nga kryetari, nga mbajtësi i procesverbalit (sekretari) dhe të gjithë ortakët e pranishëm në mbledhje ose përfaqësuesit e tyre. Drejtuesi i mbledhjes ka detyrimin që të lejojë ortakët që të kenë të gjithë kohën e nevojshme që të shqyrtojnë procesverbalin e mbledhjes. Drejtuesi i mbledhjes ka detyrimin që të perpilojë aq kopje origjinale sa ortake janë të pranishëm në mbledhje.
5. Pas nënshkrimit të procesverbalit, duhet të përgatitet vendimi i mbledhjes, i cili duhet të përmbajë midis të tjerash, numrin e radhës, datën e mbledhjes ku është marrë vendimi, bazën ligjore dhe statutore, pjesëmarrjen dhe kuorumin, vendin e mbledhjes, shprehjen e qarte të asaj që ortaket kanë rënë dakort ose jo, pozicionimin e tyre sipas çdo pike të rendit të ditës mbi të cilën është marrë një vendim, nënshkrimin e ortakeve pjesëmarrës, në rastin kur janë persona fizike dhe vulën e shoqërisë kur janë persona juridike. Vendimi mund të zbardhet (hartohet, lexohet dhe nënshkruhet dhe/ose vulloset nga të gjithë ortaket e pranishëm), ditën e mbledhjes ose në ditën e vijimit, por në asnjë rast me vonë se 10 (dhjetë) ditë pas përfundimit të



- mbledhjes. Vendimi i asamblese se ortakeve eshte i detyrueshem te behet dhe nenshkruhet (emer, mbiemer, nenshkrim, dhe vule nese ortaku eshte person juridik) ne fund te tij, ne aq kopje origjinale sa jane ortaket pjesemarres, dhe te pakten dy kopje origjinale te tjera. Vendimi si rregull nenshkruhet nga cdo ortak, ne secilen faqe, nese ka me shume se nje faqe. Njera prej tyre duhet te mbahet nga administratori, per tu rregjistruar dhe depozituar ne arkiven e shoqerise. Kopja/et e tjera mund te perdoren per rregjistrim, nese vendimi i asamblese se pergjithshme eshte parashikuar nga statuti dhe/ose nga ligji si rast i detyrueshem rregjistrimi, prane QKB apo institucioneve publike dhe/ose jopublike qe e kerkojne nje gje te tille.
6. Nje kopje e vendimeve mund tu dergohet me poste dhe ne forme elektronike ortakeve te cilet nuk kanë qënë pjesëmarres ne mbledhje, per tu vene ne dijeni me vendimet e asamblese se pergjithshme.
 7. Nëse shoqëria ka publikuar një faqe në internet, administratori, jo më vonë se 15 ditë nga data e mbledhjes, eshte i detyruar të publikojë kopje të procesverbalit të mbledhjes së asamblesë së përgjithshme në këtë faqe kur ka marre fillimisht qe ne mbledhjen perkatese te asamblese miratimin per publikim per cdo mbledhje ne veçanti.

NENI 24 **HETIMET E POSAÇME**

1. Asambleja e përgjithshme mund të vendosë nisjen e një hetimi të posaçëm për parregullsitë përgjatë veprimeve të themelimit të shoqërisë apo të ushtrimit të veprimtarisë tregtare. Hetimi kryhet nga një ekspert i pavarur i fushës, i cili miratohet me vendim të Asamblese se Pergjithshme sipas parashkimeve te ketij statuti.
2. Ortakët që përfaqësojnë të paktën 5 për qind të totalit të votave në asamblenë e shoqërisë, apo një vlerë më të vogël të parashikuar në statut dhe/ose cilido kreditor i shoqërisë mund t'i kërkojnë asamblesë së përgjithshme emërimin e një eksperti të pavarur të fushës, kur ka dyshime të bazuara për shkelje të ligjit ose të statutit.
3. Ortakët apo kreditorët e shoqërisë së përcaktuar më sipër, brenda 30 ditëve pas refuzimit nga asambleja për emërimin e ekspertit të pavarur, mund t'i kërkojnë gjykatës emërimin e këtij eksperti. Nëse asambleja e përgjithshme nuk merr një vendim brenda 60 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës, kërkesa e ortakëve vlerësohet e refuzuar.
4. Kur asambleja e përgjithshme ka emëruar një ekspert të fushës për kryerjen e hetimit të posaçëm dhe kur për këtë emërim ka dyshime të bazuara për të besuar se eksperti mund të mos realizojë hetimin e posaçëm në mënyrën e duhur, ortakët ose kreditorët e përmendur në pikën 2 të këtij neni mund t'i kërkojnë gjykatës zëvendësimin e tij.
5. Kur gjykata pranon kërkesat e përmendura në pikat 2 e 3 të këtij neni, shoqëria tregtare përballon kostot e emërimit dhe të shpërblimit të ekspertit të emëruar për kryerjen e hetimit të posaçëm.
6. E drejta për të kërkuar hetim të posaçëm, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, duhet të ushtrohet brenda 3 vjetëve nga data e regjistrimit të shoqërisë tregtare, kur hetimi ka si objekt parregullsitë e procesit të themelimit, si dhe brenda 3 vjetëve nga data e veprimit, që konsiderohet i parregullt, kur hetimi ka si objekt parregullsitë e ushtrimit të veprimtarisë tregtare.
7. Kreditori, që në keqbesim paraqet një kërkesë, sipas pikës 2 të këtij neni, përgjigjet në përputhje me nenin 34 të Kodit të Procedurës Civile.

NENI 25 **SHFUQIZIMI I VENDIMEVE TE PARREGULLTA DHE DEMSHPERBLIMI**



1. Asambleja e pergjithshme, ne baze te nje vendimi te marre me shumicen e percaktuar sipas pikes 2, neni 87, te ligjit, ka te drejte te ngreje padi perpara gjykates kompetente per shfuqizimin e vendimeve te administratoreve, si pasoje e shkeljes se rende te ligjit ose te statutit dhe/ose padi te tjera qe parashikon ky ligj ose statuti ndaj administratoreve apo ortakeve.
2. Ortaket, te cilet perfaqesojne te pakten 5 per qind te totalit te votave ne asamblene e shoqerise ose nje vlere me te vogel, te parashikuar ne statut, dhe/ose kreditorët e shoqerise, te cilet pretendojne se shoqeria ka ndaj tyre detyrime ne nje vlere jo me te vogel se 5 per qind te kapitalit, mund t'i kerkojne asamblese se pergjithshme ngritjen e padise per shfuqizimin e vendimeve te administratoreve. Ortaket apo kreditorët e shoqerise se percaktuar me siper, brenda 30 diteve pas refuzimit nga asambleja per ngritjen e padise, kane te drejte te ngrene drejtperdrejt, perpara gjykates kompetente, padi ne emer te shoqerise, per shfuqizimin e vendimit te administratoreve. Nese asambleja e pergjithshme nuk merr nje vendim, brenda 60 diteve nga data e kerkeses, kerkesa e ortakeve apo kreditorëve te percaktuar me siper vleresohet e refuzuar."
3. Asambleja e pergjithshme ka te drejte t'i kerkoje gjykatës përkatëse shfuqizimin e vendimeve të administratorëve, kur këto përbëjnë shkelje të rëndë të ligjit ose të statutit.
4. Ortakët, të cilët përfaqësojnë të paktën 5 për qind të totalit të votave në asambleshë e shoqërisë, ose një vlerë më të vogël të parashikuar në statut, apo secili prej kreditorëve të shoqërisë mund t'i kerkojnë asamblesë së pergjithshme ngritjen e padisë si më sipër. Ortakët apo kreditorët e shoqërisë së percaktuar më sipër, brenda 30 ditëve pas refuzimit nga asambleja për ngritjen e padisë, kanë të drejtë të ngrenë padi drejtpërdrejt përpara gjykatës kompetente për shfuqizimin e vendimit të administratorëve. Nëse asambleja e pergjithshme nuk merr një vendim, brenda 60 ditëve nga data e kërkesës, kërkesa e ortakëve apo kreditorëve vlerësohet e refuzuar.
5. Në rastet kur shoqëria ngre padi si më sipër, ajo merr pjesë në gjykim me anë të një përfaqësuesi të posaçëm, të caktuar nga asambleja e pergjithshme.
6. Ortakët ose kreditorët e përmendur në pikën 2 të këtij neni mund t'i kerkojnë gjykatës zëvendësimin e përfaqësuesit të posaçëm, kur ka dyshime të bazuara se përfaqësuesi i emëruar nga asambleja e pergjithshme mund të mos ngrejë e ndjekë padinë në interesin më të mirë të shoqërisë. Nëse gjykata e pranon këtë kërkesë, kostot e emërimit dhe të shpërblimit të përfaqësuesit përballohen nga shoqëria.
7. Gjykata vendos shpalljen e pavlefshmërisë së vendimit të administratorëve, nëse këta nuk merren vesh, me pajtim, me përfaqësuesin e posaçëm për korrigjimin e pasojave të vendimit, brenda 30 ditëve nga data e emërimit të këtij përfaqësuesi. Të drejtat e palëve të treta mbeten të pacenuara, në përputhje me pikën 3 të nenit 12 të këtij ligji.
8. Ortakët në pakicë dhe kreditorët e percaktuar më sipër kanë të drejtat e parashikuara në pikat 2 e 4 të këtij neni, edhe në rastin kur asambleja e pergjithshme nuk merr vendim, ose refuzon të vendosë për kërkesën e tyre për ngritjen ndaj administratorëve të padisë, me objekt shpërblimin e dëmit të pësuar nga shoqëria, si vendim i paligjshëm, apo për ngritjen e padive të tjera që parashikon ky ligj ose statuti ndaj administratorëve apo ortakëve.
9. Dispozita e paragrafit të gjashtë të nenit 91 të ligjit Nr. 9901, dt. 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare" zbatohet edhe për këto padi.

NENI 26
TE DREJTAT E LIDHURA ME KUOTEN



Ortaku, që pengohet të ushtrojë të drejtat që i rrjedhin nga zotërimi i kuotës së shoqërisë, ka të drejtë t'i kërkojë gjykatës të urdhërojë ndalimin e cenimit apo shpërblimin e dëmit të shkaktuar, si pasojë e cenimit të këtyre të drejtave.

NENI 27 **NDALIMI I KUFIZIMEVE**


1. Janë të pavlefshme dispozitat e statutit, që kufizojnë ose përjashtojnë ndonjë nga të drejtat e ortakëve ose të kreditorëve, sipas përcaktimeve të bëra në nenet 91, 92 e 93 të ligjit Nr. 9901, dt. 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", si dhe dispozitat, që parashikojnë kufizime të përgjithshme të veprimeve të përcaktuara në këto nene.
2. Vendimet e asamblesë së përgjithshme nuk mund të cenojnë të drejtën e ortakëve ose të kreditorëve për të kryer veprimet e parashikuara në nenet 91, 92 e 93 të ligjit Nr. 9901, dt. 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare".

ADMINISTRATORI

NENI 28 **EMERIMI, SHKARKIMI, TE DREJTAT DHE DETYRIMET**

1. Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit, i cili caktohet në statut, nuk mund të jetë më i gjatë se 3 (tre) vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Asambleja e Përgjithshme merr vendim të posaçëm për riemërimin e Administratorit pas periudhës së emerimit të parë. Emerimi i administratoreve, i cili hyn në fuqi në datën e përcaktuar sipas aktit të emerimit, u kundërshtohet paleve të treta sipas përcaktimeve të nenit 12 të ligjit tregtar.
2. Caktimi i Administratorit bëhet nga ky statut për një periudhë 3 (tre) vjetecare me të drejtë riemërimi nga Asambleja e Ortakut të Vetem. Administratori i parë i shoqërisë është ortaku i vetëm i shoqërisë Altin Lamaj shtetas shqiptar, madhor me zotësi juridike për të vepruar, i biri Zhezairit, lindur në datë 01.12.1976 në Tiranë, me nr. Personal H61201048D, banues në Rr. Dervish Hima, Kulla 1, shkalla 1, kati i I-re, Tiranë.

Specimeni i nënshkrimit të administratorit



3. Administratori mund të heqë dorë në çdo kohë nga detyra e tij, nëpërmjet një njoftimi me shkrim drejtuar asamblese së përgjithshme. Administratori, që jep dorëheqjen, duke pasur parasysh rrethanat e veprimtarisë së shoqërisë, është gjithashtu i detyruar të thërrasë asamblesë të përgjithshme për emërimin e administratorit të ri, përpara datës në të cilën dorëheqja të hyjë në fuqi.
4. Nëse asambleja e përgjithshme nuk vendos emërimin e administratorit të ri në datën e përcaktuar në thirrjen e kryer nga administratori i dorëhequr, atëherë administratori i njofton me shkrim dorëheqjen Qendres Kombëtare të Regjistrimit, së bashku me kopjen e thirrjes së mbledhjes së asamblese së përgjithshme dhe Qendra Kombëtare e Regjistrimit regjistron largimin e administratorit, sipas procedurave të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007, "Per Qendren Kombëtare të Regjistrimit", të ndryshuar.
5. Dorëheqja e administratorit nuk cenon paditë e shoqërisë për shkelje të detyrimit të besnikërisë që administratori ka ndaj saj, sipas këtij ligji."



Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

- a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojë shoqërinë tregtare në marrëdhënie me të tretet;
- c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- d) njoftojë ortakët për mbledhjen e shoqërisë me kërkesë të tij ose të njerit ose disa prej ortakëve;
- e) mbaje një regjister të vecantë ku të bëjë regjistrimin e të gjitha vendimeve të Asamblesë së Përgjithshme. Të mbaje të gjithë dokumentacionin e nevojshëm që duhet për çdo mbledhje, përveç të tjerave, njoftimin për thirrjen e mbledhjes, procesverbalin dhe vendimin e asamblesë të nënshkruar nga të gjithë ortakët pjesëmarrës, dhe dokumentat shoqërore që janë diskutuar në mbledhje;
- f) mbaje lidhje të ngushta me ortakët dhe të respektojë etiken në komunikim dhe marrëdhënie me ta.
- g) lidhe kontratat e punës me punonjësit e shoqërisë;
- h) mbaje korespondencë të rregullt me të tretet, si dhe të marrë të gjitha masat që kjo të jetë e arkivuar në arkivin e shoqërisë;
- i) sigurojë akses të lirë dhe të pakushtezuar për secilin prej ortakëve, që të njihet me çdo dokument që këta të fundit e vlerësojnë të rëndësishme në mbarevajtjen e veprimtarisë së shoqërisë;
- j) raportojë me shkrim ndaj asamblesë së përgjithshme për veprimtarinë tremujore të shoqërisë, edhe nëse asambleja apo secili prej ortakëve nuk e ka kërkuar shprehimisht këtë raport. Ky raport duhet të dërgohet me shkrim dhe i nënshkruar nga administratori, zyrtarisht me postë dhe/ose me postë elektronike, në adresë të ortakëve të shoqërisë.
- k) përgatise dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë, dhe së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqet këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- l) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- m) kryejë regjistrimet dhe dërgojë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- n) raportojë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- o) kryejë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në këto statut.

Në rastet e parashikuara nga pikat 3 e 5 të nenit 82 të ligjit Nr. 9901, dt. 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", administratori është i detyruar të thërrase asamblesën e përgjithshme.

NENI 29 **PERFAQESIMI**

1. Kufizimet e tagrave të përfaqësimit të administratorit i kundrejtohen palëve të treta, në përputhje me dispozitat e nenit 12 të këtij ligji.
2. Tagrat e përfaqësimit të administratorit dhe çdo ndryshim i tij njoftohet për regjistrim pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

NENI 30 **SHPERBLIMI**



1. Shpërblimit bazë të administratorit mund t'i bëhen shtesa. Shtesat bëhen me vendim të posacëm të asmblesë së ortakëve sipas nenit 86 të Ligjit nr.9901 date 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".
2. Shpërblimi, sipas pikës 1 të këtij neni, duhet të jetë i përshtatshëm dhe në përputhje me detyrat e administratorit, gjendjen financiare të shoqërisë dhe të respektojë nivelet minimale të kërkuara nga legjislacioni në fuqi.
3. Nëse shoqëria është në vështirësi financiare, asambleja e përgjithshme mund të vendosë reduktimin e shpërblimit të administratorit në masën e përshtatshme.
4. Kriteret e shpërblimit, shpërblimi individual dhe efekti vjetor i shpërblimit të administratorit në strukturën e kostove të shoqërisë tregtare publikohen së bashku me pasqyrat financiare vjetore.

NENI 31

DETYRIMI I BESNIKERISE DHE PERGJEGJESIA

1. Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit Nr. 9901, dt. 14.04.2008 "Per tregtarët dhe shoqëritë tregtare", administratori detyrohet:
 - a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj ose në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;
 - b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj ose në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
 - c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
 - ç) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;
 - d) të garantojë miratimin e marrëveshjeve sipas dispozitave të pikës 3 të nenit 13 të Ligjit nr.9901 date 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".
- këtij ligji;
2. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjet ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.
3. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave të mesiperme të këtij neni, është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ai apo personat e lidhur me të kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara.
4. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji, kryen veprimet e mëposhtme:
 - a) i kthen ortakëve kontributet;
 - b) i paguan ortakëve interesa apo dividendë;
 - c) i shpërndajnë aktivet shoqërisë;
 - ç) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
 - d) jep kredi.
5. Dispozitat e pikës 6 të nenit 92 të këtij ligji zbatohen edhe për paditë, që rrjedhin nga paragrafët e këtij neni. Këto padi duhet të ngrihen brenda 3 (tre) vjetëve nga kryerja e shkeljes apo nga zbulimi i saj.



TITULLI V
PRISHJA E SHOQËRISË, LARGIMI DHE PËRJASHTIMI I ORTAKËVE

KREU I

PRISHJA E SHOQËRISË

NENI 32

SHKAQET E PRISHJES SE SHOQERISE

1. Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar prishet:

a) kur mbaron kohezgjatja, per te cilen eshte themeluar;

b) me perfundimin e procedurave te falimentimit apo ne rast te pamjaftueshmerise se pasurive per te mbuluar shpenzimet e procedures se falimentimit;

c) ne rast se objekti behet i parealizueshem per shkak te mosfunksionimit te vazhduar te organeve te shoqerise apo per shkaqe te tjera qe e bejne absolutisht te pamundur vazhdimin e veprimtarise tregtare;

d) ne rastet e pavlefshmerise se themelimit te shoqerise, te parashikuara nga neni 3/1 i ligjit tregtar;

e) ne raste te tjera, te parashikuara ne statut;

f) ne raste te tjera, te parashikuara me ligj;

g) per cdo shkak tjeter te vendosur nga asambleja e ortakeve.

2. Prishja e shoqerise, si pasoje e nje apo me shume prej shkaqeve te percaktuara ne shkronjat "a", "c", "d", "dh" dhe "e", te pikes 1, te ketij neni, vendoset nga asambleja e ortakeve me shumicen e parashikuar sipas pikes 1, te nenit 87, te ketij ligji.

3. Ne rast mosveprimi te asamblese se ortakeve per te vendosur prishjen, per shkaqet e percaktuara me siper, cdo person i interesuar mund, ne cdo kohe, t'i drejtohet gjykates per te konstatuar prishjen e shoqerise.

4. Pavaresisht nga parashikimet e siperpermendura, ekzistenca e nje a me shume shkaqeve, te parashikuara ne kete nen, nuk do te kete si pasoje prishjen e shoqerise dhe hapjen e procedurave te likuidimit, nese perpara vendimit gjyqesor te formes se prere, shkak i prishjes eshte korrigjuar, nese eshte e mundshme te korrigjohet, dhe ky korrigjim eshte publikuar nga shoqeria ne regjistrin tregtar, sipas parashikimeve te ligjit nr. 9723, date 3.5.2007, "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit", te ndryshuar.

5. Prishja e shoqerise, si pasoje e shkaqeve te parashikuara ne shkronjen "b", te pikes 1, te ketij neni, vendoset nga gjykata kompetente per procedurat e falimentimit, kur, ne perfundim te ketyre procedurave, te gjitha pasurite e shoqerise jane likuiduar per shlyerjen ne menyre kolektive te detyrimeve ndaj kreditorëve apo kur gjykata kompetente per procedurat e falimentimit vendos rrezimin e kerkeses per hapjen e procedures se falimentimit per shkak te pamjaftueshmerise se pasurise se shoqerise per te mbuluar shpenzimet e procedures se falimentimit.

6. Prishja e shoqerise si pasoje e shkaqeve te parashikuara ne shkronjen "c", te ketij neni, vendoset nga gjykata kompetente, sipas parashikimeve te nenit 3/1 te ligjit tregtar.



NENI 33
REGJISTRIMI I SHPERBERJES

1. Administratori ka detyre te regjistroje shperberjen e shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, në përputhje me nenin 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”. Nëse prishja e shoqërisë bëhet me vendim gjykate, gjykata, në përputhje me nenin 45 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” ia njofton vendimin Qendrës Kombëtare të Regjistrimit për regjistrim.
2. Ne rastin e shperberjes se shoqerise, pavaresisht institucionit qe ka marre vendimin asamblese dhe/ose gjykates, ngarkohet administratori qe te kryeje procedurat deri ne perfundim te ketij procesi, per aq kohe sa, kjo dispozite e statutit nuk vjen ne kundersiztim me legjislacionin ne fuqi.

KREU II
LARGIMI DHE PËRJASHTIMI I ORTAKËVE

NENI 34
LARGIMI I ORTAKUT PER SHKAQE TE ARSYESHME

1. Ortaku mund të largohet nga shoqëria nëse ortakët e tjerë ose shoqëria kanë kryer veprime në dëm të tij, nëse është penguar të ushtrojë të drejtat e tij, nëse shoqëria i ka ngarkuar detyrime të paarsyeshme apo për shkaqe të tjera, që e bëjnë të pamundur vazhdimin e ortakërisë.
2. Ortaku që kërkon largimin, duhet të njoftojë shoqërinë me shkrim, si dhe të parashtrijë shkaqet e largimit.
3. Administratori duhet të thërrase mbledhjen e asamblesë së përgjithshme menjëherë pasi të ketë marrë dijeni për njoftimin e largimit, sipas pikës 2 të këtij neni, për të vendosur nëse ortakut do t'i anulohet dhe/ose likuidohet kuota, si pasojë e largimit për shkaqe të arsyeshme.
4. Ortaku ka të drejtë të ngrejë padi në gjykatë ndaj shoqërisë për likuidimin e kuotës, si pasojë e largimit për shkaqe të arsyeshme, nëse pas njoftimit të largimit asambleja e përgjithshme nuk mblidhet apo nuk njeht si të arsyeshme shkaqet e largimit dhe likuidimin e kuotës.
5. Ortaku që largohet ka të drejtë të ngrejë padi ndaj shoqërisë dhe/ose ortakëve të tjerë që shkaktuan largimin e tij dhe të kërkojë ndaj tyre, në mënyrë solidare, shpërblimin e dëmit të pësuar.

NENI 35
PERJASHTIMI I ORTAKUT

1. Asambleja e përgjithshme mund t'i kërkojë gjykatës përjashtimin e ortakut, nëse ai nuk ka shlyer kontributin e tij, sipas parashikimeve të statutit ose nëse ekzistojnë shkaqe të tjera të arsyeshme për këtë përjashtim.
2. Konsiderohen shkaqe të arsyeshme për përjashtimin e ortakut, sipas pikës 1 të këtij neni, por pa u kufizuar në to, rastet kur ortakut:
 - a) me dashje apo me pakujdesi të rëndë i shkakton dëme shoqërisë ose ortakëve të tjerë;
 - b) me dashje apo me pakujdesi të rëndë shkel statutin ose detyrimet e përcaktuara me ligj;
 - c) përfshihet në veprime, të cilat e bëjnë të pamundur vazhdimin e marrëdhënieve midis shoqërisë tregtare dhe ortakut; ose
 - d) me veprimet e tij dëmton ose pengon ndjeshëm veprimtarinë tregtare të shoqërisë.
 - e) Mungon për me shume se dy mbledhje rresht ne asamblene e pergjithshme, duke mosmarre pjese persoanisht e as me perfaqesues, ne menyre te pa justifikuar, dhe pa

njoftim paraprak, megjithese ka pasur njoftim te rregullt sipas parashikimeve te ketij statuti.

3. Gjatë procedurës së përjashtimit të ortakut, me kërkesë të paditësit, gjykata mund të marrë një masë për sigurimin e padisë, duke pezulluar të drejtën e votës së ortakut, që kërkohet të përjashtohet, si dhe të drejtat e tjera, që rrjedhin nga zotërimi i kuotës së shoqërisë, kur ajo e vlerëson këtë masë si të nevojshme dhe të justifikuar.
4. Shoqëria ka të drejtë t'i kërkojë ortakut të përjashtuar shpërblimin e dëmit të pësuar nga veprimet, që kanë sjellë përjashtimin.
5. Ortaku ka të drejtë t'i kërkojë shoqërisë shpërblimin e dëmit të pësuar, nëse kërkesa për përjashtim nuk është e bazuar.
6. Ortaku nuk ka të drejtë t'i kërkojë shoqërisë likuidimin e kuotës, nëse ai përjashtohet për shkaqe të arsyeshme, por, nëse shoqëria ngre ndaj tij padi për shpërblim dëmi, ortakut ka të drejtë të kompensojë çdo shumë, që do të kishte të drejtë ta përfitonte në cilësinë e likuidimit të kuotës, me dëmin e kërkuar nga shoqëria.

NENI 36

PASOJAT E LARGIMIT DHE PERJASHTIMIT

1. Të gjitha të drejtat që rrjedhin nga cilësia e ortakut në shoqëri, shuhen në datën e largimit ose të vendimit të formës së prerë të gjykatës për largimin ose përjashtimin.
2. Statuti nuk mund të përjashtojë apo të kufizojë të drejtën e ortakut për t'u larguar nga shoqëria dhe të drejtën e shoqërisë për të përjashtuar ortakun.

NENI 37

LIKUIDIMI NE GJENDJEN E AFTESISE PAGUESE

Me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi, prishja e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, sipas neneve 190 deri në 205 të këtij ligji.

NENI 38

Dispozita tranzitore dhe te fundit

1. Per cdo gje qe nuk eshte parashikuar shprehimisht ne kete statut qe lidhet me funksionimin e shoqerise, zbatohet legjislacioni shqiptar ne fuqi ne momentin e nenshkrimit te ketij satuti.
2. Ne cdo rast kur legjislacioni shqiptar perkates mund te ndryshoje, ky statut me vendim te asamblese se ortakeve, sipas rregullave te percaktuara mund te ndryshohet, ne perputhje me ndryshimet perkatese te legjislacionit ne fuqi.
3. Ky statut hartohet ne tre kopje origjinale, dhe hyn ne fuqi per palet nenshkruese nga data e nenshkrimit te tij dhe prodhon efekte ndaj te treteve nga data e rregjistrimit te tij ne QKB.
4. Ortaku i vetem mund te autorizojë cdo person te caktuar prej tij, sipas ligjit, per depozitimin e ketij statuti prane QKB dhe kryerjen e aplikimit per rregjistrimin e shoqerise.

ORTAKU I VETEM THEMELUES I SHOQERISE TESORO-AL SH.P.K

Altin Lamaj

Emer, Mbiemer, Firma.